



# GAZETA

semm.mk

Këshilli për etikë në media  
në Maqedoni

Viti 2017

numri 3

## Përmbajtje

- Vetërregullimi nuk është censurë, por rregullim pa sanksione.....1
- Vetërregullim, në vend të rregullimit të mediave onlajn ..... 1
- Pesë storjet më të mira gazetareske për vitin 2017 sipas KEMM..... 2
- Informacione falas nga MIA për portal-et të cilat i kanë respektuar standardet për raportim ..... 2
- Publikime dhe analiza..... 3
- Rritet numri i parashtresave për raportim joprofesional ..... 4
- Marina Tuneva: Konsolidimi i profesionit të gazetarisë duhet të ndodh në redaksitë ..... 5
- Mirçe Adamçevski: Si për më pak ankesa e më shumë etikë? ..... 5
- Marina Tuneva: Reforma serioze për çlirimin e mediave..... 6
- Marina Tuneva: Nevojitet partneritet gjithëpërfshirës ndërsektorial..... 6
- Punëtori për komunikimin strategjik të KEMM..... 6

## Vetërregullimi nuk është censurë, por rregullim pa sanksione



Gazetarinë duhet së bashku ta vendosim aty ku e ka vendin, ndërsa kjo nuk do të thotë prodhim i përmbajtjeve, por servis për informim konsekuent, etik dhe informim i vërtetë i opinionit. Ky ishte një prej mesazheve të cilat u përcollën në konferencën vjetore të Këshillit për etikë në mediat në Maqedoni (KEMM) "Vetërregullimi medial dhe sfidat etike në media", që u mbajt më 17 maj, në Shkup.

Në konferencë u promovua vetërregullimi në media, ndërsa veçanërisht u adresuan problemet me vetërregullimin medial në botën digjitale. Është prioritarë ta largojmë gënjeshtren dhe propagandën prej mediave, ndërsa më pas edhe mospërputhjet e tjera në sjelljen etike", deklaroi Dragan Antonovski i Këshillit Drejtues të KEMM. Shefja e Misionit të OSBE-së në Maqedoni, Nina Soumalainen, jeggjës i TV 24 dhe zëvendësredaktori përgjegjtheksoi se "vetërregullimi nuk është censurë,

e as vetëcensurë, por do të thotë rregullim pa sanksione dhe paraqet alternativë të besueshme për procedurat gjyqësore dhe ndihmon që të rritet gazetaria etike e cila është e orientuar drejt fitimit të besimit".

"Këshilli për etikë në media ka rol fisnik, vazhdimisht i përkujton mediat dhe gazetarët për etikën profesionale. Bëhet fjalë për parime të cilat nuk e mbrojnë vetëm profesionin dhe anëtarët e saj por edhe demokracinë dhe ndikimin e saj më të gjerë", vlerëson shefi i Delegacionit të BE-së në Maqedoni, Samuel Zhbogar.

Për rolin e mediave në demokratizimin e shtetit, gazetarinë sot, si dhe për nevojën e profesionalizimit në punën e mediave folën edhe Mlladen Çadikovski, kryeredaktor përgjeggjës i TV 24 dhe zëvendësredaktori përgjeggjës i TV Alsat -M, Isuf Kadriu.



*"Nevojitet mbështetje e plotë politike për përforcimin e lirisë së mediave përmes kushteve të sigurta për punën profesionale të gazetarëve. Është fakt se lajmet e mira nuk mund të dalin prej praktikave të këqija, por edhe se nuk ekziston diçka siç është fraza t'u japim pak liri mediave. Ose ato do të jenë tërësisht të lira ose nuk do të jenë fare, ndërsa çmimi i kësaj lirie është përgjegjësia."*

- Marina Tuneva, drejtoreshë ekzekutive e KEMM

## Vetërregullim, në vend të rregullimit të mediave onlajn

Rregullimi i mediave onlajn është i panevojshëm dhe i pamundshëm, ndërsa internet portalet duhet ta garantojnë integritetin e tyre në mënyrë transparente dhe me strukturë dhe politikë redaktuese. Ky është një prej mesazheve në ngjarjen të cilën së bashku e organizuan SHGM dhe KEMM në nëntor.

Sipas kryetarit të SHGM-së Naser Selmani, Maqedonia si vend anëtar i Këshillit të Evropës ka për obligim ta respektojë dhe promovojë rekomandimin për lirinë e internetit prej vitit 2016. Mirçe Adamçevski nga KEMM, nga ana tjetër vlerëson se edhe pse mediat onlajn nuk janë përfshirë me ligjet e mediave në Maqedoni, ato rregullohen me dispozita prej ligjeve të tjera të cilat kanë të bëjnë me sferën e mediave onlajn.

"Vetërregullimi është më efikas se rregullimi i mediave të internetit. Në kushte të ndryshimeve të vazhdueshme të teknologjive mediale ai ofron fleksibilitet më të madh në krahasim me rregullimin shtetëror. Ai është më efikas dhe zgjat më shkurt se kontestet gjyqësore të gjata dhe komplekse", thotë Adamçevski.

## KEMM DHE MEDIAT

## Pesë storjet më të mira gazetareske për vitin 2017 sipas KEMM



Këshilli për etikë në media i shpërbleu pesë storjet të cilat ishin të përqendruara në zhvillimin e të drejtave të njeriut dhe promovimin e të drejtave të grupeve të prekura sociale dhe të marginalizuara.

Çmimin e parë e fitoi storja e gazetares Irena Mullaçka nga Fokus për skandalin në Gjinekologjinë e Shkupit pasi disa mjekë të punësuar në Klinikë, zbuluan se 80 foshnja kanë vdekur për gjashtë muaj.

Storja e cila e fitoi çmimin e dytë është e autorit Nikolla Zdravkoviç, për kronikën me titull "Tragedia familjare lë pa bukë Gordana Sllavkoviç", e publikuar në kuadër të emisionit 360 gradë në Televizionin Alsat-M.

Çmimin e tretë e morën dy punime gazetareske. I pari është i gazetares Mirjana Mirçevska – Jovanoviç për serialin kronika për "Ivanin e vogël dhe gjyshen e tij", i publikuar në TV Kanal 5, ndërsa i dyti është i gazetarit Marijan Nikolovski për kronikën "A munden bashkësitë fetare t'i heqin të gjitha barrierat për lutje të papenguar", e publikuar në TV Sitell, në emisionin "Në anën e njejtë".

KEMM i ndau dy mirënjohje – për storje gazetareske autores Maja Ravanska, për tekstin "Stiven Hopkingu i Maqedonisë i mbytur në pargjet e shoqërisë joinkluzive", e botuar në gazetën "Lice v lice" dhe për kronikën televizive "Le të shohin ata që duhet parë" të autorit Zoran Jovanovski, nga projekti 360 gradë, në TV Alsat -M.

Çmimet janë ndarë në konkursin i cili u mbështet nga UNESCO dhe BE në kuadër të projektit "Ndërtimi i besimit në mediat në Evropën Juglindore dhe në Turqi".

## Informacione falas nga MIA për portalet të cilat i kanë respektuar standardet për raportim etik

Portalet e internetit të cilat e kanë respektuar Kodin e gazetarëve të Maqedonisë dhe Deklarimit për raportim të KEMM kanë mundur falas t'i transmetojnë informacionet e Agjencisë Informative të Maqedonisë (MIA) tre muaj, deri në përfundimin e zgjedhjeve lokale në tetor, 2017.

Ideja e nismës së përbashkët të MIA-s, KEMM dhe SHGM ishte që në këtë mënyrë të përmirësohen standardet profesionale të gazetarisë.

"Rregullat, standardet, parimet ekzistojnë, ata i kanë për një kohë të gjatë, vetëm duhet të gjithë ne së bashku të përkujtohemi se përgjegjësia për krijimin e një të ardhme të tillë të gazetarisë profesionale qëndron pikërisht në duart e mediave", deklaroi për nismën Marina Tuneva, drejtreshë ekzekutive e KEMM. Sipas kryetarit të SHGM-së, Naser Selmani, kjo është një nga mënyrat e përforsimit të vetërregullimit në media.


80 foshnje të sapo lindura kanë vdekur për tetë muaj




Tragedia familjare lë pa bukë Gordana Sllavkoviç




Ivanin e vogël dhe gjyshen e tij



A munden bashkësitë fetare t'i heqin të gjitha barrierat për lutje të papenguar



Le të shohin ata që duhet parë




Stiven Hopkingu i Maqedonisë i mbytur në pargjet e shoqërisë joinkluzive



## PUBLIKIME DHE ANALIZA

## RAPORTIM NË INTERES TË OPINIONIT – MBROJTJA E PARIMEVE ETIKE TË RAPORTIMIT PËRMES KOMISIONIT PËR ANKESA



Publikimi ka për qëllim të kontribuojë drejt mirëkuptimit më të madh të vetërregullimit dhe drejt ngritjes së nivelit të profesionalizmit, transparencës dhe llogaridhënies së mediave.

Ai ofron përqendrim ndaj respektimit të disa prej parimeve kryesore të etikës gazetareske dhe shqyrtimit të vendimeve më karakteristike të sjella nga Komisioni për ankesa në kuadër të KEMM. Për vetëm tre vite ekzistim, në KEMM janë dorëzuar rreth 200 ankesa prej opinionit lidhur me përmbajtjet e publikuara në mediat e shtypit, elektronike dhe mediat onlajn, ndërsa numri i ankesave ndryshon pothuajse çdo ditë.

Për shkak të vëllimit të materialit, publikimi nuk ofron shqyrtimin për të gjitha vendimet e Komisionit për ankesa, por vetëm të atyre që lidhen me shkeljen e parimeve më të rëndësishme të raportimit gazetaresk. Shqyrtimin më të detajuar të vendimeve mund ta gjeni në [www.semm.mk](http://www.semm.mk). Autorë të publikimit janë dr. Sefer Tahiri dhe Mirçe Adamçevski, ndërsa redaktore është dr. Snezhana Tërpevska.

## SHQYRTIM I PËRVOJAVE DHE PRAKTIKAVE PREJ KËSHILLAVE NDËRKOMBËTARE PËR ETIKË NË MEDIA

Ideja e këtij shqyrtimi është të sigurohet shqyrtim i përvojave dhe praktikave në ballafaqimin me çështje të caktuara prej këshillave për etikë – anëtare të Aleancës për këshilla të pavarura për etikë në media (AIPCE), por edhe të kodeve të tyre profesionale.

Fokusi është vënë në dispozitat e tyre sa i takon disa çështjeve të caktuara sensitive, siç janë: mbrojtja e personalitetit dhe privatësisë, parandalimi i diskriminimit në baza të ndryshme, mbrojtja e fëmijëve dhe minorenëve, raportimi për krim, vetëvrasje etj. Rezultatet janë të dobishme për opinionin e ekspertëve, por edhe më gjerë për opinionin, i cili duhet prej afër të njoftohet me punën, qasjen dhe përfitimet e ekzistimit dhe funksionimit të KEMM si trup për vetërregullim. Autor i publikimit është dr. Dejan Donev.

## SHQYRTIM I PËRVOJAVE DHE PRAKTIKAVE PREJ KËSHILLAVE NDËRKOMBËTARE PËR ETIKË NË MEDIA



## VETËRREGULLIMI APO RREGULLIMI I MEDIAVE TË INTERNETIT NË MAQEDONI



A ka nevojë prej zgjidhjeve ligjore të cilat do ta rregullonin punën e internet-mediave? Ose, çështjet profesionale mund të zgjidhen në kuadër të vetë profesionit përmes mekanizmave vetërregullatore?

Kjo dilemë në Maqedoni u hap për shkak të domosdoshmërisë nga sigurimi i informacioneve të sigurta dhe të pavarura në hapësirën e internetit dhe zvogëlimin e abuzimeve dhe dukurive negative, si gjuha e urrejtjes, diskriminimi, nacionalizmi, lajmet e rrejshme dhe propagandat, por edhe për shkak krijimit të konkurrencës jolojale të mediave tradicionale dhe internet mediave të cilat i respektojnë rregullat profesionale dhe rregullat e biznesit. Që këtu, kjo analizë i përshkruan postulatet ligjore dhe standardet etike të cilat kanë të bëjnë me internet-mediat dhe i identifikon disa prej problemeve me të cilat ballafaqohet gazetaria e internetit në Maqedoni. Gjithashtu, jep vështrim të shkurtër për disa standarde dhe rekomandime prej trupave ndërkombëtare relevante dhe ofron shembuj të mekanizmave prej praktikës ndërkombëtare për ballafaqim me problemet etike dhe profesionale të internet mediave.

## INFORMIM PËR MISIONIN E KEMM

### Rritet numri i parashtrësive për raportim joprofesional

KEMM organizoi një sërë debatesh në disa qytete gjatë vitit që prej së afërmi ta njoftojë opinionin me punën e këtij trupi vetërregullator, por edhe të stimulohet procesi i shtrimit të ankesave për raportim joetik në media.

”Opinionin vazhdimisht reagon ndaj rasteve të raportimit joprofesional. Dhe kjo do të thotë se qytetarët gjithnjë e më shumë i njohin format e raportimit propagandues dhe misionar. Deri më tani në KEMM janë paraqitur mbi 220 raste të informimit joetik”, deklaroi drejtoresha ekzekutive e Këshillit, Marina Tuneva në debatin në Tetovë.

Në takimin me qytetarët u informua se në punën trevjeçare të KEMM qytetarët zakonisht janë ankuar për informimin e njëanshëm, diskriminimin, gjuhën e urrejtjes dhe plasimin e lajmeve të rrejshme në media, veçanërisht në sferën onlajn. Zakonisht janë shkelur nenet e Kodit të gazetarëve të cilat kanë të bëjnë me saktësinë e informacioneve, dallimin midis fakteve dhe mendimeve, lajmeve dhe komentimit, me balancimin, si dhe paanshmërinë gjatë raportimit për procese politike.

Duke diskutuar për problemet të cilat janë hasur më shpesh gjatë raportimit medial, në debate u prezentua procesi i mediacionit apo ndërmjetësimit, si dhe mënyra e parashtrimit të ankesave në KEMM. Përfaqësuesit e Këshillit, e theksuan rëndësinë e mbështetjes së fuqishme të vetërregullimit, përmes rritjes së anëtarësimit në Këshill, me kusht që të respektohen kriteret për raportim konsekuent dhe profesional.

Shqyrtim më i detajuar i vendimeve të KEMM në LINKUN VIJUES.



Debat në Tetovë



Debat në Shkup



Debat në Veles

### Takime të tjera të përfaqësuesve në KEMM



Takim me Këshillin austriak për etikë në Vjenë



Takim me përfaqësues të Federatës Evropiane të Gazetarëve (EFJ), Qendra Evropiane për lirinë e shtypit dhe mediave dhe të Organizimit medial të Evropës Juglindore



Pjesëmarrje e KEMM në Platformën mediale për bashkëpunim CIVICA



Debat me pasdiplomikët e Institutit për studime komunikuese

## PËR GAZETARINË PROFESIONALE DHE ETIKE

*Nga debati në TV24: Çfarë gazetarie dhe çfarë media i nevojiten Maqedonisë?*



### Marina Tuneva: Konsolidimi i profesionit të gazetarisë duhet të ndodh në redaksitë

„Me krijimin e dëmeve të mëdha në gazetari si pasojë e mënyrës së informimit prej disave të cilët pohojnë se i takojnë profesionit ose prej disave të cilët e patën fuqinë publikisht të flasin përmes mediave, konsolidimi i profesionit të gazetarisë duhet të ndodh në redaksitë. Ata duhet ta parashtrojnë pyetjen se si më tej, duke mos i harruar punët të cilat janë konstatuar. Gjithsesi vetërregullimi ka rëndësi të madhe, ajo që deri më tani ishte shqiptuar si sanksion moral nga Këshilli për etikë në media. Por duhet edhe vetë të rimendohen se çfarë ka ndodhur si rezultat i të gjitha presioneve, të gjendjeve

të këqija në gazetari. A do të bëhet kjo përmes mbështetjes publike dhe mbështetjes të rezervë të trupit vetërregullues ose vetë do të krijojnë praktika të cilat do të nënkuptojnë rrugë drejt profesionalizmit, për dallim prej asaj që paraprakisht do të nënkuptonte mënyrë të gabuar të punës, është çështje e zgjedhjes.

Shumë shpesh është folur se si shteti mund t'i rregullojë gjendjet në gazetari, por ku është theksi mbi atë qka vetë mediat mund të rregullojnë. Duhet mbështetje e madhe për procesin e vetërregullimit, rikthim i praktikës vetërregulluese në redaksitë, mediat më shumë të bashkëpunojnë, më shumë të dëgjohet opinioni, qytetarët të reagojnë. Pikërisht për këtë egziston ky trup i vetërregullimit i cili mundëson lidhjen e qytetarëve me mediat, trup i cili nëse mbështetet do të mundësojë korrigjimin e joprofessionalizmit në media, por edhe plotësimin e interesit të opinionit”.

*Nga konferenca e-Shoqëri e OJQ Metamorfozis në Shkup*

### Mirçe Adamçevski: Si për më pak ankesa e më shumë etikë?

“Fillimisht, gazetarët sikur e kanë harruar atë që e mësojnë që në ditët e para të studimeve të gazetarisë. Se informacionet duhet të jenë të sakta dhe të verifikuara. Ndoshta në mbi 70 për qind të të gjitha parashtresave është përcaktuar se sikur është lektion i harruar nga fakulteti apo redaksia.

Së dyti, interesi privat goditet pa iu trembur syri gazetarit për pasojat prej marrëdhënies së tillë. Më pas, si të harrohet se gjuha e urrejtjes është vepër penale dhe diskriminimi mbi baza të ndryshme. Gjithashtu gazetarët më shumë duan të komentojnë se sa të raportojnë dhe të punojnë në bazë të fakteve.

Fakti sikur është kategori e fshirë. Nuk ka kultivim të kulturës së të shprehurit dhe zhdukjes së komunikimit të pandershëm me opinioin. Harrohet edhe se raportimi për zgjedhjet duhet të jetë i paanshëm dhe i balancuar.

Në Komisionin për ankesa numri më i madh i parashtresave janë dorëzuar kundër mediave onlajn. Shpiken tema, lajme, ngjarje, madje kemi publikim kolektiv të një teksti të njejtë, pa u ndryshuar as pikë e as presje. Ka tekste me shumë gënjeshtër të kulluara, pasi që nuk mbështeten në fakte. Tekste në të cilat thuhet “mësuam”, ndërsa nuk thuhet “e dimë”. Gazetarët duhet të mësojnë, por jo vetëm prej një burimi ose prej një qendre për marrëdhënie me opinionin. Kemi parashtresa kundër mediave të cilave nuk mund t’ua gjejmë adresën për të komunikuar, as nuk kanë impresum e as redaksi.

Pyetja e cila para nesh si KEMM tani parashtrohet është se si më tej. Si të rritet profesionalizmi dhe si të ngritet etika në media? Përgjigjja nuk është e thjeshtë.



Veçanërisht kur bëhet fjalë për mediat onlajn. Radiodifuzerët deri diku janë rregulluar me ligj, por edhe më tej duhet të ndryshojë diçka që të mundet t’u jepen përgjigje sfidave të reja për etikën. Po shohim se gjërat po shkojnë drejt një lloji rregullimi të internetit. Me siguri në pjesën e etikës mediat onlajn tërësisht do t’i nënshtrohen vetërregullimit, ndërsa do të ketë edhe një lloj regjistrimi, siç është tani me mediat e shtypit.

Çfarëdo që të ndodh, të gjithë ata të cilët merren me media duhet të përgatiten që gjithçka të përfundojë në mënyrën më të mirë të mundshme për mediat dhe jo të jemi në gjendje diktimi nga shteti, pavarësisht se cila parti do të jenë në pushtet. Kjo do të jetë sfidë edhe për trupin vetërregullator. Dhe kjo duhet të përshtatet me risitë, ndërsa më së paku që duhet bërë është ta harmonizojmë Kodin ekzistues me kohërat e reja dhe kërkesat e reja.

## PËR GAZETARINË PROFESIONALE DHE ETIKE

Marina Tuneva: Reforma serioze për  
çlirimin e mediave

Nga Konferenca e OSBE-së në Vjenë "Liria e mediave në Ballkanin Perëndimor"

„Në përgjithësi mediat nuk duan t'i publikojnë vendimet e KEMM, që tregon për angazhimin e ulët të vetërregullimit të standardeve etike.

Për fat, gjërat gradualisht filluan të ndryshojnë. Angazhimet e vazhdueshme për zhvillimin e kulturës të etikës profesionale çuan në reagime më të shpeshta nga opinioni.

Këshilli për etikë në media asnjëherë nuk ka qenë nën iluzionin se vetërregullimi medial mund t'i japë rezultatet e pritshme nëse qeveria nuk vepron me përgjegjësi dhe përzihet në sektorin medial. Vetërregullimi nuk mund të ballafaqohet me dhunën ndaj gazetarëve, përgjimin e gazetarëve, korrupsionin në media dhe ndikimin politik dhe partiak ndaj rregullatorit medial dhe servisit publik radiodifuziv – RTM. Na nevojiten reforma serioze të cilat do t'i çlirojnë mediat prej presionit të politikës dhe biznesit.“

Marina Tuneva: Nevojitet partneritet  
gjithëpërfshirës ndërsektorial

Nga konferenca vjetore e Alenacës së këshillave të pavarur për etikë në mediat në Evropë (AIPCE) në Budapest

„Vetërregullimi ngadalë është duke e marrë vëmendjen e nevojshme, me mbështetjen e sektorit civil, veçanërisht kur bëhet fjalë për ndjekjen e sjelljes mediale. Duket se ekziston nevoja e partneritetit më gjithëpërfshirës ndërsektorial në disa nivele dhe me përfshirjen e palëve të ndryshme të involvuara.

Në këtë drejtim, KEMM tenton të vendos bashkëpunim të mirë me sistemin e arsimit të lartë, industrinë mediale, gjyqësinë, organet e parandalimit të diskriminimit dhe mediave që të ndihmojnë në ripërtëritjen e kredibilitetit të profesionit të gazetarisë. Gjithashtu e kuptuam, se nevojiten konsultime të rregullta me strukturat menaxhuese në media që të stimulohen që në mënyrë aktive të marrin pjesë në promovimin e konceptit për vetërregullim. Përveç kësaj, ekziston nevoja që në mënyrë aktive të punohet me qytetarët, veçanërisht me nxënësit dhe gjeneratat më të reja, që t'ju ndihmojmë që t'i kuptojnë format e raportimit joprofesional dhe ta mbështesin punën tonë.“

## Kuvendi i rregullt vjetor i KEMM

Punëtori për komunikimin strategjik të  
KEMM

Në takim u diskutua për misionin e KEMM, praktikën e deritanishme të komunikimit me opinionin dhe qytetarët si dhe për qëllimet strategjike për periudhën e ardhshme.

Ngjarja rezultoi me përgatitjen e strategjisë komunikuese, qëllimi i së cilës është afrimi aktiv i punës së KEMM më pranë qytetarëve dhe stimulimi i bashkëpunimit më të madh dhe mbështetjes së këtij trupi vetërregullues.



Kingdom of the Netherlands